



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

## PROJEKTVENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

### PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT MË TË HOLLËSISHME TË ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KËSHILLAVE VENDOR TË SIGURISË PUBLIKE DHE KËSHILLIT KOMBËTAR PËR SIGURINË NË KOMUNITET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 12/1, të ligjit nr. 107/2016, “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Përbërjen, rregullat më të hollësishme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet.
2. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike kryesohet nga Kryetari i Bashkisë dhe përbëhet nga:
  - a) Shefi i Komisarariatit të Policisë;
  - b) Drejtuesi i Policisë Bashkiake;
  - c) Përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar;
  - d) Drejtori ose shefi i sektorit të MZSH-së në bashki;
  - e) Përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror;
  - f) Përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;
  - g) Përfaqësuesi i Njesisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor;
  - h) Përfaqësuesi i Agjencisë Rajonale të Mjedisit;
  - i) Përfaqësuesi i Drejtorisë Rajonale të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
  - j) Përfaqësuesi i Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura;
  - k) Koordinatori vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare;
  - l) Përfaqësues nga Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe/ose Policisë Ushtarake;
  - m) Përfaqësuesi i njesisë për mbrojtjen e fëmijëve;
  - n) Kryeinspektori i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit;
  - o) Përfaqësuesi i Agjencisë së Mbrojtjes së Konsumatorit;
  - p) Përfaqësuesi i Inspektoratit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut;
  - q) Përfaqësuesi i shoqatave të njësive të vetëqeverisjes vendore;
  - r) Përfaqësuesi i shoqatave të mbrojtjes së konsumatorëve.

3. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike funksion si një organizëm koordinues, identifikues dhe konsultues mbi problematikat që lidhen me çështjet e rendit dhe sigurisë në komunitet.
4. Kryetari i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, mund të ftojë përfaqësues të:
  - a) Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm;
  - b) Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm;
  - c) Partive politike me përfaqësim në Këshillin Bashkiak;
  - d) Komuniteteve fetare;
  - e) Organizatave të shoqërisë civile.
5. Kryetari i Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, ushtron përgjegjësitë si më poshtë:
  - a) Ndërmerr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar funksionimin efektiv dhe efikas të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike;
  - b) Organizon mbledhjet e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike minimalisht 1 (një) herë në 3(tre) muaj, ose sa herë vlerësohet e nevojshme nga anëtarët e tij;
  - c) Identifikon përgjegjësitë institucionale për zbatimin e prioriteteve mbi çështjet e sigurisë;
  - d) Këshillon anëtarët e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike për të ndërmarrë veprime në lidhje me çështjet e sigurisë publike;
  - e) Aprovon pas miratimit nga të gjithë anëtarët, raportin mbi diskutimet, rezultatet, rekomandimet dhe vendimet për çdo takim të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike;
  - f) Paraqet dhe informon për takimin e radhës më të afërt, mbi vendimet apo rekomandimet e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike;
  - g) Përfaqëson Këshillin Vendor të Sigurisë Publike në marrëdhëniet me të tretët, duke përfshirë dhe bashkëpunimet me organizmat ndërkombëtare;
  - h) Mbledh në takimet e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike anëtarët e ftuar;
6. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike, ushtron këto detyra dhe përgjegjësi:
  - a) Angazhohet për parandalimin, minimizimin e rreziqeve dhe kërcënimeve në çështjet që cenojnë sigurinë në komunitet;
  - b) Analizon dhe vlerëson situatën mbi çështjet e sigurisë në komunitet;
  - c) Identifikon dhe evidenton problematikat lidhur me sigurinë në komunitet dhe i trajton ato në takimet e këshillit;
  - d) Referon për zgjidhje, problematikat e rasteve konkrete përmes kryetarit, tek autoritetet kompetente shtetërore, pjesëmarrëse ose jo në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike;
  - e) Identifikon prioritetet në fushën e sigurisë në komunitet dhe rekomandon përfshirjen e tyre në mbledhjen e radhës.
  - f) Kontrollon dhe vlerëson detajet e veprimtarisë së institucioneve me përgjegjësi për sigurinë publike në komunitet dhe i komunikon ato drejtuesve të tyre;
  - g) Shqyrton dhe miraton kërkesat mbi nevojën e financimit të projekteve apo aktiviteteve, të lidhura me sigurinë në komunitet dhe kërkon mundësi për financimin e tyre;
  - h) Verifikon dhe vlerëson nivelin e kapaciteteve të strukturave të sigurisë vendore dhe bën rekomandime për përmirësimin e tyre;
  - i) Kontribuon dhe siguron pjesëmarrje në aktivitete ndërgjegjësuese për komunitetin, edhe përmes projekteve mbi çështjet e sigurisë në komunitet;

- j) Merr në shqyrtim përmbushjen e rekomandimeve mbi çështjet e trajtuara në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike;
- k) Përcakton përbërjen e sekretariatit Teknik.

7. Sekretariati teknik ushtron këto detyra:

- a) Përgjigjet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së këshillit nga ana logjistike dhe administrative;
- b) Mban, ruan dhe përditëson të gjitha kontaktet e anëtarëve të këshillit;
- c) Organizon dhe bën koordinimin e mbledhjeve të këshillit;
- d) Njofton anëtarët për mbledhjen e radhës;
- e) Përgatit materialet përkatëse paraprake të mbledhjes, sipas rendit të ditës për anëtarët;
- f) Merr pjesë në mbledhjet e këshillit duke mbajtur minutat e takimit;
- g) Shkëmben informacionin dhe materialet e mbledhjes, midis anëtarëve;
- h) Harton procesverbalet e mbledhjes dhe raportet;
- i) Mban listën e pjesëmarrësve të pranishëm në mbledhje;
- j) Protokollon dhe mban arkivën e procesverbaleve të mbledhjeve;
- k) Kontrollon adresën elektronike, si mjet të komunikimit elektronik të këshillit;
- l) Përgatit dhe bën publikimin e njoftimeve apo materialeve të ndryshme për publikun.

8. Këshilli Vendor i Sigurisë Publike zhvillon mbledhjet në bazë të rendit të ditës të miratuar nga Kryetari dhe anëtarët, sipas procedurës:

- a) Njoftimi për datën e zhvillimit të mbledhjes, dërgohet të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara datës së përcaktuar, me shkresë zyrtare ose në formë elektronike, për të cilën anëtarët kanë rënë dakord;
- b) Anëtarët njoftohen paraprakisht edhe për rendin e ditës dhe për çdo informacion tjetër të nevojshëm;
- c) Në përcaktimin e çështjeve të rendit të ditës mund të kontribuojnë edhe anëtarët;
- d) Propozime për rendin e ditës mund të dërgohen edhe përmes adresës elektronike nga çdo qytetar;
- e) Mbledhjet mbahen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të përhershëm të këshillit, në rastet kur ky numër nuk plotësohet, mbledhja shtyhet në një datë tjetër, por jo më vonë se 3 (tre) ditë pune;
- f) Në rastet e ngjarjeve të papritura apo me ndjeshmëri të veçantë, Kryetari organizon mbledhje me anëtarësi më të vogël pjesëmarrësish që lidhen drejtpërdrejt me çështjen, por duke njoftuar të gjithë anëtarët mbi rezultatet e çështjeve të diskutuara.
- g) Mbledhja hapet dhe drejtohet nga Kryetari, i cili bën edhe prezantimin e rendit të ditës, si dhe një përmbledhje të zhvillimeve të fundit të punës së këshillit;
- h) Kryetari drejton diskutimin, përcakton fillimin dhe përfundimin e shqyrtimit të secilës çështje të rendit të ditës;
- i) Anëtarët diskutojnë në bazë të rendit të ditës;
- j) Në mbledhje shqyrtohen me hollësi të gjitha problemet dhe çështjet e parashtruara sipas rendit të ditës, por anëtarët kanë të drejtën e propozimit për të diskutuar edhe çështje të tjera.
- k) Në përfundim të mbledhjes, mbahet procesverbal nga sekretariati teknik, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët dhe kryetari;

- l) Në procesverbal mbahet shënim listën e pjesëmarrësve në mbledhje, përfshirë edhe emrat e anëtarëve që nuk kanë marrë pjesë, të cilët duhet njoftojnë me shkrim arsyet e mospjesëmarrjes;
  - m) Vendimet merren me konsensusin e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
  - n) Pas çdo mbledhjeje, publiku informohet, përmes një njoftimi në faqen zyrtare të institucionit, mbi: datën e mbledhjes, pjesëmarrjen, çështjet e shqyrtuara në rendin e ditës dhe përmbledhjen e diskutimeve;
  - o) Publikimi i njoftimit bëhet brenda 3 ditëve pune nga zhvillimi i mbledhjes.
9. Vendimet e marra në Këshillin Vendor të Sigurisë Publike, dërgohen pranë Prefektit të Qarkut, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e tyre.
10. Prefekti i Qarkut pas çdo vendimi të marrë nga Këshilli Vendor i Sigurisë Publike, informon Këshillin Kombëtar të Sigurisë në Komunitet.
11. Këshilli Kombëtar për Sigurinë në Komunitet funksionon si organ kolegjal, i cili kryesohet nga Zëvendësministri i Brendshëm dhe ka në përbërje përfaqësues në nivel zëvendësministri të:
- a) Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
  - b) Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
  - c) Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
  - d) Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
  - e) Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
  - f) Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit;
  - g) Ministrisë së Mbrojtjes;
  - h) Ministrisë së Drejtësisë;
  - i) Ministrin të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
  - j) Ministrin të Shtetit për Pushtetin Vendor.
12. Kryetari i Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet, mund të ftojë përfaqësues të:
- a) Prokurorisë së Përgjithshme;
  - b) Avokatit të Popullit;
  - c) Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
  - d) Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
  - e) Komuniteteve fetare;
  - f) Organizatave të Shoqërisë Civile.
13. Përgjegjësitë e kryetarit të Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet, janë:
- a) Thërret dhe drejton mbledhjet e Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet, si rregull 2 (dy) herë në vit;
  - b) Miraton rendin e ditës dhe raportin përfundimtar të mbledhjeve;
  - c) Informon Ministrin e Brendshëm për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet;
  - d) Prezanton raportin vjetor të Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet pranë Ministrin të Brendshëm.

14. Detyrat dhe përgjegjësitë e Këshillit Kombëtar për Sigurinë në Komunitet janë:
- Identifikon përmes raporteve të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike, çështjet problematike të sigurisë në komunitet, me qëllim parandalimin dhe zgjidhjen e tyre pranë institucioneve përkatëse shtetërore qendrore;
  - Relaton nëpërmjet raporteve dhe analizave tek Ministri i Brendshëm, nevojën për hartimin e politikave të caktuara në fushën e sigurisë publike;
  - Orienton Këshillin Vendor të Sigurisë Publike mbi aplikimin dhe përfshirjen e praktikave më të mira, në trajtimin e çështjeve të sigurisë në komunitet;
  - Rekomandon Këshillin Vendor të Sigurisë Publike për zbatimin në mënyrë të njëjtë të politikave kombëtare në fushën e sigurisë;
  - Garanton marrëdhënie bashkëpunimi të ndërsjellët me Këshillin Vendor të Sigurisë Publike.
15. Drejtoria e Politikave të Rendit dhe Sigurisë Publike në Ministrinë e Brendshme, në rolin e Sekretariatit teknik, ushtron këto detyra:
- Përgjigjet për mbarëvajtjen e veprimtarisë së këshillit nga ana logjistike dhe administrative;
  - Mban, ruan dhe përditëson të gjitha kontaktet e anëtarëve të këshillit;
  - Organizon dhe bën koordinimin e mbledhjeve të këshillit;
  - Njofton anëtarët për mbledhjen e radhës;
  - Përgatit materialet përkatëse paraprake të mbledhjes, sipas rendit të ditës për anëtarët;
  - Merr pjesë në mbledhjet e këshillit duke mbajtur minutat e takimit;
  - Shkëmben informacionin dhe materialet e mbledhjes, midis anëtarëve;
  - Harton procesverbalet e mbledhjes dhe raportet;
  - Mban listën e personave të pranishëm në mbledhje;
  - Protokolon dhe mban arkivën e procesverbaleve të mbledhjeve;
16. Këshilli Kombëtar i Sigurisë në Komunitet zhvillon mbledhjet në bazë të rendit të ditës të miratuar nga Kryetari, sipas procedurës:
- Njoftimi për datën e zhvillimit të mbledhjes, dërgohet të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara datës së përcaktuar, me shprehje zyrtare ose në formë elektronike, për të cilën anëtarët kanë rënë dakord;
  - Anëtarët njoftohen paraprakisht edhe për rendin e ditës dhe për çdo informacion tjetër të nevojshëm;
  - Në përcaktimin e çështjeve të rendit të ditës mund të kontribuojnë edhe anëtarët;
  - Mbledhjet mbahen kur janë prezentë më shumë se gjysma e anëtarëve të përhershëm të këshillit, në rastet kur ky numër nuk plotësohet, mbledhja shtyhet në një datë tjetër, por jo më vonë se 3 (tre) ditë pune;
  - Mbledhja hapet dhe drejtohet nga Kryetari, i cili bën edhe prezantimin e rendit të ditës, si dhe një përmbledhje të zhvillimeve të fundit të punës së këshillit;
  - Kryetari drejton diskutimin, përcakton fillimin dhe përfundimin e shqyrtimit të secilës çështje të rendit të ditës;
  - Anëtarët diskutojnë në bazë të rendit të ditës;

- h) Në mbledhje shqyrtohen me hollësi të gjitha problemet dhe çështjet e parashtruara sipas rendit të ditës, por anëtarët kanë të drejtën e propozimit për të diskutuar edhe të çështjeve të tjera.
  - i) Në përfundim të mbledhjes, mbahet procesverbal nga sekretariati teknik, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët dhe kryetari;
  - j) Në procesverbal mbahet shënim lista e pjesëmarrësve në mbledhje, përfshirë edhe emrat e anëtarëve që nuk kanë marrë pjesë, të cilët duhet njoftojnë me shkrim arsyet e mospjesëmarrjes;
  - k) Vendimet merren me konsensusin e anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
17. Këshillat Vendor të Sigurisë Publike dhe Këshilli Kombëtar për Sigurinë në Komunitet, ngrihen brenda 3 muajve nga botimi i vendimit në Fletoren Zyrtare.
18. Ngarkohen prefekti i qarkut, institucionet e përmendura në pikën 2 dhe pikën 11, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Edi Rama**

**MINISTRI I BRENDSHËM**

**Taulant Balla**